REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT - OPŠTINA UROŠEVAC - MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT - UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 05 / 10 / 2026
Nr.Org.jed. 01 Nr.Prot. Br.Prot. 109 Nr.Faqeve. Br.Strana. 1
Ferizaj - Uroševac

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.109
Data: 30.09.2026

Bazuar në nenin 12, paragrafin 12.2 pika d, nenit 40, paragrafi 40.2 pika b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L- 040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 61, paragrafi 61.2 të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; Neni 25, paragrafi 2 pika 2.2 dhe nenit 45, paragrafi 1.2 dhe 3 të , Statutit të Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50 të datës 28.06.2013, dhe në bazë të Qarkoreve Buxhetore 2027-01 dhe 2027-02 nga MFPT, Kuvendi i Komunës të Ferizajt, në seancën e mbajtur me datë: 30.09.2026 miratoi këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË FERIZAJT PËR VITIN 2027 DHE VLERËSIMET E HERSHME BUXHETORE 2028-2029

I

Me këtë vendim miratohet Buxheti i Komunës së Ferizajt për vitin 2027 dhe vlerësimet e hershme buxhetore 2028-2029

II

Shuma e buxhetit të Komunës së Ferizajt për vitin 2027 i cekur në pikën I të këtij vendimi është

56,102,329.00 € dhe atë në kategori ekonomike si më poshtë:

Kategoritë buxhetore		Viti 2027	Viti 2028	Viti 2029
1.	Paga dhe shtesa	**24,561,220.00 €**	24,684,027.00 €	24,807,447.00 €
2.	Mallra dhe shërbime	**12,183,659.00 €**	14,391,227.00 €	15,447,577.00 €
3.	Shpenzimet komunale	**1,457,062.00 €**	1,530,000.00 €	1,644,750.00 €
4.	Subvencione	**2,550,000.00 €**	2,720,000.00 €	2,820,000.00 €
5.	Shpenzimet kapitale	**15,350,388.00 €**	15,582,251.00 €	17,395,010.00 €
TOTALI:		**56,102,329.00 €**	58,907,504.00 €	62,114,784.00 €

III

Pjesë përbërse e këtij vendimi është Buxheti I Komunës së Ferizajt për vitin 2027 dhe vlerësimet e hershme buxhetore 2028-2029 në kuadër të të cilit është edhe tabela e përgjithshme e shpërndarjes së buxhetit

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e Komunës.

Kryesues i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 05 / 10 / 2026
Nr.Orgv Org.jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 111 | Nr. Faqeve. Br. Strana. 2
Ferizaj - Uroševac

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.111
Data: 30.09.2026

Në bazë të nenit 8 pika 3 Të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 Për Proceduren e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, të nenit 10 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, të nenit 12 të Ligjit për Vetqeverisje Lokale nr.03/L-040, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.09.2026 miratoi këtë:

VENDIM

Për Themelimin e Panelit Përzgjedhës për Krijimin e Komitetit Konsultativ për Perosna me Nevoja të Veçanta.

Neni I

Miratohet propozimi I Kryetarit të Komunës me nr: 01.Nr.243/26 i datës 18.09.2026 Për Themelimin e Panelit Përzgjedhës për Krijimin e Komitetit Konsultativ për perosna me nevoja të veçanta.

Neni II

Ky panel duhet të ketë gjithësej (5) pesë, anëtar prej të cilëve (3) tre do të jenë nga Kuvendi i Komunës, (1) një anëtarë nga egzekutivi dhe (1) një anëtarë nga shoqëria civile, dhe atë:

1. z.Maliq Muharremi (Kuvendi i Komunës)
2. z.Fisnik Nazifi (Kuvendi i Komunës)
3. VEND I REZERVUAR (Kuvendi i Komunës)
4. VEND I REZERVUAR (zyrtarë nga ekzekutivi)
5. Znj.Aolta Bajrami (nga shoqëria civile)

Neni III

Ky komision do ti propozoj Kuvendit të Komunës listën e anëtarëve të Komitetit Konsultativ.

Neni IV

Për këtë vendim do të kujdeset Kuvendi I Komunës Ferizajt si dhe Kryetari i Komunës.

Neni V

Ky vendim hyn në fuqi (tridhjetë) 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi I KK-së

Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT - OPŠTINA UROŠEVAC - MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT - UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 05 / 10 / 2026
Nr.Orgv Org.jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 112 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 1
Ferizaj - Uroševac

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.NR.112
Data: 30.09.2026

Në bazë të nenit 12 të ligjit nr 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale si dhe nenit 51 paragrafi 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.09.2026 miratoi këtë:

VENDIM

Për Miratimin e raportit të vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga data 02.07.2026 deri më 10.08.2026 nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, të hartuara më 14.09.2026.

I

Miratohet raporti i Komisionit të vlerësimit të dëmeve materiale nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është i bashkangjitur edhe raporti i detajuar i komisionit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore.

III

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset drejtoria e shërbimeve emergjente në Komunën e Ferizajt si dhe Kuvendi i Komunës.

IV

Ky vendim hyn në fuqi (tridhjetë) 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi I KK-së

Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 05 / 10 / 2026
Nr.Orgv Org. jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 113 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 1
Ferizaj - Uroševac

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.113
Data:30.09.2026

Në bazë të nenit 12 të ligjit nr: 03/L-040 për vetëqeverisijen Lokale, neni 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 i datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datë 30.09.2026 miratoi këtë:

VENDIM
Për
Anulimin e vendimit 01.Nr.90 i datës 31.07.2026.

Neni I

Me anë të këtij vendimi anulohet vendimi 01.Nr.90 i datës 31.07.2026 për ngritjen e tarifave, ndryshimi I rregullores 01.Nr.124 për Parkingjet Publike në Komunën e Ferizajt.

Neni II

Qëllimi i këtij anulimi është, pasi që MAPL e ka cilësuar si të pa ligjshëm sa i përket aspektit formal.

Nneni III

Për realizimin e këtij vendimi do të përkujdeset Kuvendi i Komunës si dhe Drejtoraia për shërbime Publike dhe Emergjenca Ferizaj.

Neni IV

Ky vendim hyn në fuqi (tridhjetë) 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi I KK-së

Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 05 / 10 / 2026
Nr.Orgv Org.jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 114 | Nr. Faqeve. Br. Strana. 1
Ferizaj - Uroševac

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.114
Data: 30.09.2026

Në bazë të nenit 12 të ligjit nr: 03/L-040 për vetëqeverisijen Lokale, neni 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 i datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datë 30.09.2026 miratoi këtë:

VENDIM
Për
Anulimin e vendimit 01.Nr.91 i datës 31.07.2026.

Neni I

Me anë të këtij vendimi anulohet vendimi 01.Nr.91 i datës 31.07.2026 për miratimin e rregullorës për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Ferizajt

Neni II

Qëllimi i këtij anulimi është, pasi që MAPL e ka cilësuar si të pa ligjshëm sa i përket aspektit formal.

Nneni III

Për realizimin e këtij vendimi do të përkujdeset Kuvendi i Komunës si dhe Drejtoraia për shërbime Publike dhe Emergjenca Ferizaj.

Neni IV

Ky vendim hyn në fuqi (tridhjetë) 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi I KK-së

Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 05/10/2026
Nr.Orgv Org. jed. 115
Nr. Faqeve Br. Strana: 3
Ferizaj - Uroševac

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.115
Data: 30.09.2026

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit, Nr. 03/L -040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 pika 2.9, të Statutit Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50, i datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 30.09.2026 miraton këtë:

RREGULLORE
Për
Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjevnë territorin e Komunës së Ferizajt 01.Nr.124 të datës 22.12.2023).

Neni I

Qëllimi i kësaj Rregullore është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve në territorin e Komunës së Ferizajt 01.Nr.124 të datës 22.12.2023.

Neni II

Me këtë rregullore ndryshohet dhe plotësohen neni 15 paragrafi 5 pika 1 i Rregullorës për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve në territorin e Komunës së Ferizajt 01.Nr.124 të datës 22.12.2023, konkretisht tabela me numër 1 *"Çmimore për rrugë dhe hapësira të hapura publike"* dhe tabela me numrin 3 *"Çmimore për parking garazh"*.
Tabelat me plotësimin e çmimeve për parkingje publike ndryshohen si në vijim:

Tabela 1. Çmimore për rrugë dhe hapësira të hapura publike.

Nr.	Emërtimi	Çmimet për 1 orë me Tvsh
1.	Rruga "Dëshmorët e Kombit"	1.00 €
2.	Rruga "Vëllezërit Gërvalla"	1.00 €
3.	Rruga "Besim Rexhepi"	1.00 €
4.	Rruga "Ramadan Rexhepi"	1.00 €
5.	Rruga "Tahir Sinani"	1.00 €

6.	Parkingje në hapësira publike të hapura	1.00 € për 3 orë

Tabela 3. Çmimore për Parking Garazhë

Shërbimet	**0-5 min falas 6 min deri 3 orë**	**Ditore**
Parking me kohë të caktuar	1.50 €	€ 5.00
	Mujore	**Vjetore**
Parking i rezervuar për persona fizik	50 €	500 €
Parking i rezervuar për persona juridik	70 €	650 €
Parking për banorët rezident-Vetura 1	25 €	250 €
Parking për banorët rezident-Vetura 2	30 €	300 €
Parking për banorët resident - Vetura 3+	40 €	400 €

Arsyetim

Plotësimi dhe ndryshimi i çmimeve për parkingje publike është bërë vetëm për kategorin *"Parking me kohë të caktuar"*, duke marrë parasysh ndryshimet e çmimeve në nivel të përgjithshëm, gjithashtu një faktor tjetër i rëndësishëm është rritja e pagës minimale në Republikën e Kosovës.

Rritja e pagës minimale ka ndikuar drejtpërdrejti në shpenzimet e personelit të angazhuar në administrimin, mirëmbajtjen, mbikëqyrjen dhe menaxhimin e parkingjeve publike.

Ndryshimi i çmimeve të propozuara do ti krijonte ndërmarrjes publike lokale "Ambienti" mundësi në ngritjen e cilësis dhe ofrimit të shërbimeve, digjitalizimin të shërbimeve, investime në personelin e angazhuar dhe qëndrueshmëri financiare për ndërrmarjen.

Neni III

Kjo rregullore hyn në fuqi (tridhjetë) 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

01.Nr.115
Data: 30.09.2026

Kryesuesi I KK-së

Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT - OPŠTINA UROŠEVAC - MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT - UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 05 / 10 / 2026
Nr.Orgv Org.jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 116 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 2
Ferizaj - Uroševac

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.116
Data: 30.09.2026

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit Nr. 03/ L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor 2008), nenit 13 pika1.2 lidhur me nenin 15 të Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina (Gazeta Zyrtare (Nr.17/2012) dhe nenit 51 paragrafi 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 30.09.2026 miraton këtë;

RREGULLORE
Për
Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Territorin e Komunës së Ferizajt, Nr.01/Nr.109, të datës 31.08.2022.

Neni I

Me anë të kësaj rregullore plotësohet-ndryshohet rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në Territorin e Komunës së Ferizajt, Nr.01/Nr.109, të datës 31.08.2022, këto ndryshime janë ta paraqitura në tabelen si në vijim:

Kategoritë e klientëve	Propozimi për çmim të ri (pa TVSH)	Propozimi për çmim (me TVSH)
Amvisëritë (Të rregullta)	8.39 €	9.90 €
Amvisëritë (Mërgata – Faturë PAUSHALLE)	4.63 €	5 €
Tarifë Fikse	1 €	1.18 €
Bizneset me tarifa - kat. 1	13.80 €	14.90 €
Bizneset me tarifa - kat. 2	21.20 €	22.9 €
Bizneset me tarifa - kat. 3	36.02 €	38.9 €
Bizneset me kontratë 1.1 m^3	23.98 €	25.9 €

Bizneset me kontratë 5.0 m³	101.76 €	109.9 €
Institucionet me kontratë 1.1 m³	23.98 €	25.9 €
Institucionet me kontratë 5.0 m³	101.76 €	109.9 €
Bizneset me tarifa - kat. 4	111.05 €	119.9 €
Kategori e veçantë - kat. 5	/ / / / / / / /	Vlera e Tarifës - E papërcaktuar Tarifa caktohet nga Kompania e Licencuar për Grumbullimin dhe Bartjen e Mbeturinave

A r s y e t i m

Ky ndryshim i Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Territorin e Komunës së Ferizajt, Nr. 01/Nr.109, të datës 31.08.2022, bëhet me qëllim të përshtatjes dhe përmirësimit të dispozitave të rregullores, në funksion të menaxhimit më efikas të mbeturinave në territorin e Komunës së Ferizajt. Gjithashtu, me këtë ndryshim dhe plotësim rregullohet edhe **Neni 5, pika 5**, lidhur me mënyrën dhe kushtet e vendosjes së kontejnerëve për mbeturina, me qëllim të sigurimit të një organizimi më të përshtatshëm dhe funksional të shërbimit të grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave..

Neni II

Kjo rregullore hyn në fuqi (tridhjetë) 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

01.Nr.116
Data: 30.09.2026

Kryesuesi I KK-së

Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT - OPSTINA UROŠEVAC - MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT - UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Data e Izlazne. Date / Dana. 05 / 10 / 2026
Nr. Org. jed. 112
Nr. Faqeve. 1

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.117
Data: 30.09.2026

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datë 30.09.2026 miratoi këtë:

VENDIM
Për rishqyrtimin e vendimit 01.Nr.59 i datës 29.05.2026

I

Me anë të këtij vendimi rishqyrtohet vendimi me nr 59 i datës 29.05.2026 vetëm sa i përket rregullimit në fletëposeduese pasi që, më parë prona 1794-0 Z.K.Ferizaj ishte në pronësi të P.SH.Mirëmbajtja e Rrugëve, dhe tani është Komuna e Ferizajt.

II

Ky rishqyrtim vjen pas kërkesës së MAPL-së, dhe të gjitha pikat tjera tjera që nuk preken nga ky vendim mbesin në fuqi.

III

Ky vendim hyn në fuqi (tridhjetë) 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi I KK-së

Xhavit Zariqi